



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Pjetër Shalës, u mbajtën seanca të hënën dhe të martën e kësaj jave. Dëshmoi dëshmitari i nëntë, një ekspert mjekoligjor, i thirrur nga Prokuroria në këtë çështje gjyqësore.

Të martën, më 27 qershor, Trupi Gjykues lëshoi dy urdhra gojorë në këtë çështje gjyqësore: i pari në lidhje me pyetjet e Mbrojtjes për dëshmitarin ekspert dhe i dyti në lidhje me kërkesën e Mbrojtjes për shtyrjen e mbylljes së fazës së paraqitjes së provave të Prokurorisë.

Në lidhje me këtë dëshmitar ekspert, Mbrojtja kërkoi të shtyhet fillimi i pyetjeve të Mbrojtjes, në mënyrë që Mbrojtja të ketë kohë të mjaftueshme për t'u konsultuar me ekspertin e vet dhe për t'u përgatitur për ta marrë në pyetje këtë dëshmitar. Trupi Gjykues rrjedhimisht mori vendimin për të shtyrë fillimin e pyetjeve të Mbrojtjes për këtë dëshmitar deri të hënën, më 3 korrik.

Sidoqoftë, për të garantuar kryerjen efikase dhe të shpejtë të procesit, Trupi Gjykues i kërkoi Mbrojtjes që të sigurohej se do të jetë në gjendje të konsultohet me ekspertët e vet, nëse është e nevojshme, edhe gjatë seancave të javës së ardhshme, duke mbajtur parasysh dëshmitë e dy dëshmitarëve të tjerë ekspertë që pritet të dëshmojnë.

Në një urdhër tjetër gojor, Trupi Gjykues mori vendim mbi kërkesën e Mbrojtjes për shtyrjen e mbylljes së fazës së paraqitjes së provave të Prokurorisë. Mbrojtja dëshiron të parashtrojë kundërshtim në lidhje me vendimin për pranimin si prova të deklaratave me shkrim të dy dëshmitarëve në vend të dëshmimeve të tyre të drejtpërdrejta, dhe i kërkoi Trupit Gjykues të shtyjë mbylljen e paraqitjes së provave të Prokurorisë deri në marrjen e vendimit për këtë. Trupi Gjykues refuzoi kërkesën e Mbrojtjes për shtyrjen e mbylljes së paraqitjes së provave të Prokurorisë, pasi konstatoi se kjo nuk do të ishte në interes të kryerjes efikase të procesit.

Në gjykimin e Pjetër Shalës, seancat u mbyllën për këtë javë dhe do të vazhdojë të hënën, me seanca të planifikuara për gjithë javën e ardhshme.

Gjykimi i çështjes *Thaçi dhe të tjerët* do të vazhdojë pas javës së ardhshme, duke filluar nga 10 korriku.

Pyetje nga gazetarët

